

## UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS



### Njihuni me ekselentët e vitit akademik 2025

Universiteti Bujqësor i Tiranës vlerësoi studentët ekselentë të vitit 2025 si model suksesi dhe përkushtimi akademik, duke theksuar rëndësinë e tyre në promovimin e cilësisë dhe traditës së ekselencës në universitet.

**Lexo në faqen 3**

### UBT diplomon 1500 studentë mes emocionesh dhe frymëzimi për të ardhmen


Ceremonia e diplomimit në Universitetin Bujqësor të Tiranës u zhvillua në një atmosferë festive dhe emocionale, ku mbi 1500 studentë përmbyllën me sukses studimet e tyre. Në këtë event morën pjesë edhe përfaqësues të lartë shtetërorë, si ministrat Mirela Kumbaro dhe Andis Salla. Rektori Prof. Dr. Fatbardh Sallaku vlerësoi të diplomuarit ndërsa sipërmarrësi Altin Prenga i frymëzoi ata të jenë inovatorë në sektorin e bujqësisë. Ceremonia u shoqërua me performanca artistike dhe kulmoi me shpërndarjen e diplomave dhe hedhjen simbolike të kapelave. **Lexo në faqen tjetër...**

# Ceremonia plot ngjyra e diplomimit



Kënaqësi dhe krenari e madhe për Universitetin Bujqësor të Tiranës ishte ceremonia e diplomimit të këtij viti, ku mbi 1500 studentë përmbyllën me sukses një etapë të rëndësishme të formimit të tyre akademik dhe hodhën hapat e parë drejt sfidave të reja profesionale.

Kjo ceremoni u nderua nga prania e Znj. Mirela Kumbaro, Ministre e Arsimit, dhe Z. Andis Salla, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rura. Në fjalët e tyre përshëndetëse, ata vlerësuan rolin e arsimit të lartë dhe të UBT-së në zhvillimin e vendit, duke inkurajuar të diplomuarit që të kontribuojnë në sektorët strategjikë të ekonomisë.



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, në fjalën e tij përshëndetëse theksoi rëndësinë e këtij momenti për studentët dhe për vetë universitetin, duke nënvizuar se të diplomuarit e sotëm janë një aset i çmuar për të ardhmen e vendit dhe një reflektim i cilësisë së arsimit që ofron UBT.

Një mesazh frymëzues përcolli sipërmarrësi i njohur Altin Prenga, alumni i UBT-së dhe themelues i Mrizi i Zanave, i cili i inkurajoi studentët të bëhen “influencerë të bujqësisë”, duke promovuar vlerat e tokës dhe potencialin e sektorit në mënyrë moderne dhe inovative.



Një dimension artistik dhe festiv i shtoi gjallëri ceremonisë përmes performancës së studentit Ibrahim Rustemaj së bashku me Ansamblin e Shkollës “Qemal Stafa”, të cilët interpretuan valle popullore, duke sjellë në skenë ritmet dhe traditat shqiptare. Ceremonia u shënuar edhe nga vlerësimi i me certifikatë mirënjohje për 12 studentë, të cilët u nderuan për arritjet e tyre të larta, duke u kthyer në modele frymëzimi për të gjithë komunitetin studentor. **Lexo më shumë...**



## Ekselentët e UBT për vitin akademik 2025

Universiteti Bujqësor i Tiranës vijon të konsolidojë traditën e ekselencës akademike, duke vlerësuar studentët me arritje të larta dhe ata ekselentë për vitin akademik 2025.

Ndër ta janë: Adela Bushi, Arlind Qoli, Belinda Dhami, Estela Pinderi, Erta Cali, Fjona Allko, Gledis Sina, Letisia Muça, Mateo Lazri, Uendi Gjata, Sergej Qama dhe Rabie Ahmetaj, të cilët kanë arritur rezultate të larta dhe janë vlerësuar për përkushtimin e tyre në studime.

Në total, 13 studentë u shpallën ekselentë për vitin 2025, duke përfaqësuar nivelin më të lartë të arritjeve akademike në universitet. Në mënyrë të veçantë, titullin e ekselentes me notë absolute e ka merituar Klea Ramaliu Lena, e cila përfaqëson kulmin e ekselencës akademike në UBT dhe një model frymëzimi për të gjithë studentët.

UBT mbetet i përkushtuar në krijimin e një brezi të ri profesionistësh të kualifikuar, të cilët jo vetëm do të kontribuojnë në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe shkencave të jetës, por edhe në përparimin e përgjithshëm të vendit. Studentët me arritje të larta dhe ekselentët e vitit 2025 janë dëshmi konkrete e këtij misioni. **Lexo më shumë...**



# Kërkimi shkencor, UBT-AADF marrëveshje strategjike



*Nisma synon të forcojë kapacitetet e institucioneve të arsimit të lartë për kërkimin shkencor*

Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) formalizuan një partneritet strategjik që çon përpara një vizion të përbashkët për forcimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri. Në thelb të kësaj marrëveshjeje qëndron zbatimi i programit Research Expertise from the Academic Diaspora (READ) dhe komponentit të tij të ri, BRIDGE një nismë e financuar plotësisht dhe e ideuar nga AADF. [Lexo më shumë...](#)



**UBT dhe IKMT bashkojnë forcat për territorin dhe mjedisin**

Gjatë Prillit, UBT firmosi një marrëveshje bashkëpunimi edhe me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, duke hapur më shumë mundësi për praktika profesionale, trajnim dhe punësim për studentët, veçanërisht të Fakultetit të Shkencave Pyjore. Një nga komponentët kryesorë të marrëveshjes është angazhimi i stafit akademik të UBT-së në trajnimin dhe kualifikimin e inspektorëve të IKMT-së. [Lexo më shumë...](#)





## UBT TALK- Ruzhdi Koni- Nga ëndrra për futbollist te sukcesi në bujqësi moderne

Ruzhdi Koni dikur ëndërronte të bëhej futbollist. Studimet në Universitetin Bujqësor të Tiranës nuk erdhën si rezultat i pasionit, por si një zgjedhje e imponuar nga sistemi i para viteve 90.

Megjithatë, me kalimin e kohës, ai kuptoi se pikërisht profesioni i agronomit do t'i siguronte një jetë që nuk e kishte imagjinuar kurrë.

Pasi ndërtoi pikën e tij të parë të grumbullimit dhe punoi si tregtar frutash dhe perimesh, Ruzhdiu e kuptoi se e ardhmja e biznesit kërkonte një drejtim të ri.

Në vitin 2007, ai themeloi fidanishten "Agro Koni", e cila sot prodhon një gamë të gjerë perimesh dhe bashkëpunon me mbi 2000 fermerë nga e gjithë Shqipëria, të cilët kanë lidhur kontrata me këtë kompani. **Shiko videon e plotë...**

## UBT-BOKU 2030 prezantohet si model bashkëpunimi universitar në publikimin ndërkombëtar "Trigon Themen"

Bashkëpunimi mes Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Universitetit të Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës në Vjenë (BOKU) është prezantuar si një model i suksesshëm transformimi institucional në botimin ndërkombëtar "Trigon Themen 01/26". Sipas këtij botimi, projekti UBT-BOKU 2030 përfaqëson një qasje të avancuar të zhvillimit organizativ dhe bashkëpunimit akademik ndërkombëtar.

Botimi "Trigon Themen" është një publikim periodik profesional i organizatës Trigon Entwicklungsberatung, i fokusuar në zhvillimin e organizatave, leadershipin dhe bashkëpunimet ndërinstitucionale, duke sjellë raste konkrete nga biznesi, sektori publik dhe universitetet në Evropë. Sipas botimit, projekti UBT-BOKU 2030 synon ta pozicionojë Universitetin Bujqësor të Tiranës si një universitet modern të shkencave të jetës deri në vitin 2030, përmes një transformimi të thellë që përfshin qeverisjen, mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. **Lexo më shumë...**

AXISBEISPIEL: UNIVERSITÄT

KOOPERATION  
ENTWICKELN

WANDEL WIRKSAM BEGLEITEN




VON ANIKA STORK

---

Wie gelingt die internationale Organisationsentwicklung jenseits von Blaupausen? Das Projekt AUT-BOKU 2030 zeigt, wie professionelle Prozessbegleitung und der bewusste Umgang mit Spannungen den Weg von unterstützender Zusammenarbeit zu nachhaltiger Kooperation auf Augenhöhe ermöglichen.

In der **PHASE 1** steht die interne Reorganisation der AUT im Mittelpunkt. Die BOKU bringt hier ihre strukturelle, fachliche und strategische Expertise ein. Orientierungspunkt ist das Organisations- und Governance-Modell der BOKU, das nicht kopiert, sondern kontextsensibel adaptiert wird. Ziel ist es, die AUT in ihrer Eigenständigkeit, Steuerungsfähigkeit und internationaler Anschlussfähigkeit zu stärken.



## Drejt Ekselencës: UBT nis valën e parë të mbrojtjeve të doktoraturës në fusha strategjike shkencore

Doktorantët Adri Erebara, Anjeza Bekolli, Elvis Kamberi dhe Gladiola Malollari përfunduan studimet e tyre të doktoraturës nën bashkëudhëheqjen e profesorëve të shquar nga Gjermania, Spanja dhe Italia.

Puna e tyre akademike u përforcua më tej përmes qëndrimeve kërkimore dhe bashkëpunimeve me institucione të njohura evropiane, përfshirë Universitetin e Hohenheim-it në Gjermani, Universitetin e Split-it në Kroaci, Institutin e Ekosistemeve Detare dhe Shkencës së Peshkimit, Universitetin e Hamburgut në Gjermani, Universitetin e Alicante-s në Spanjë, Universitetin e Molise-s në Itali dhe Institutin TROPOS në Leipzig, Gjermani. Këto përvoja reflektohen qartë në publikimet e tyre ndërkombëtare dhe prodhimin shkencor.

Kërkimet e tyre doktorale trajtojnë tema shumë të rëndësishme dhe me ndikim:

- Potenciali i ruajtjes së karbonit blu në lagunat bregdetare shqiptare dhe roli i tyre në zbutjen e ndryshimeve klimatike (Adri Erebara).
- Aplikimi i teorisë së lojërave bashkëpunuese në zinxhirët agroushqimorë për shpërndarje të drejtë dhe efikase të vlerës (Anjeza Bekolli).
- Ndikimet afatgjata të ndryshimeve klimatike dhe presionit të peshkimit mbi ekosistemet detare në Detin Adriatik (Elvis Kamberi).
- Profilizimi i avancuar i aerosoleve atmosferike dhe vlerësimi i cilësisë së ajrit përmes teknologjive lidar tokësore dhe satelitore (Gladiola Malollari).

**Lexo më shumë...**





## UBT dhe partneritetet për të ardhmen e bujqësisë në "Agriculture Days 2026"

Universiteti Bujqësor i Tiranës mori pjesë në panairin ndërkombëtar të bujqësisë "Agriculture Days 2026", i zhvilluar në Lushnje, duke u prezantuar si një nga institucionet kryesore të dijes dhe inovacionit në sektorin agroushqimor në Shqipëri. Në stendën e tij, universiteti prezantoi programet e reja bachelor, tërësisht të rishikuara dhe të harmonizuara sipas standardeve evropiane nën supervizionin e Universitetit BOKU.

Nga UBT, në panelet e diskutimit kontribuuan Prof. Dr. Endrit Kullaj dhe Prof. Dr. Valbona Hobdari nga Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve, të cilët ndanë perspektiva mbi zhvillimin e bujqësisë dhe rolin e kërkimit shkencor.



Në panelin e organizuar nga GIZ Albania, drejtoresha e IRGJB ndau rëndësinë e ruajtjes dhe promovimit të farave autoktone si pasuri kombëtare dhe themel për një bujqësi të qëndrueshme. **Lexo më shumë...**



## UBT pjesë e Panairit të 5-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor në Tiranë

Universiteti Bujqësor i Tiranës ishte pjesë e Panairit të 5-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, i cili u çel në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, duke mbledhur institucione akademike, studiues dhe studentë nga Shqipëria dhe rajoni.

UBT u përfaqësua me stendën e tij me botime akademike dhe shkencore, e cila tërhoqi interes të lartë nga vizitorët gjatë gjithë ditës së parë të panairit. **Lexo më shumë...**






### UBT në çerekfinale në futsal dhe basketboll

Ekipet sportive të Universiteti Bujqësor i Tiranës shënuan një arritje të rëndësishme në sportin universitar, duke u kualifikuar deri në fazën çerekfinale në të dyja disiplinat, si në futsal ashtu edhe në basketboll, në kuadër të Turneut Universitar të Tiranës 2026.

Ky sukses dëshmon angazhimin dhe shpirtin garues të studentëve, të cilët arritën të përballen me universitetet më të mira dhe të sigurojnë një vend në fazën më vendimtare të garës, duke përfaqësuar denjësisht universitetin në të dyja sportet.

**Lexo më shumë...**



### Nga teoria në terren: studentët e UBT në praktikë mësimore në Ulëz

Studentët e viteve të para dhe të dyta zhvilluan një praktikë mësimore në zonën e Ulëz në kuadër të lëndëve Fitopatologji dhe Entomologji Pyjore, nën udhëheqjen e profesor Ramiz Metalia. Kjo praktikë kishte si qëllim njohjen nga afër me sëmundjet e bimëve dhe insektet që ndikojnë në ekosistemet pyjore.



Gjatë aktivitetit, studentët vëzhguan lloje të ndryshme dëmtuesish dhe simptomash sëmundjesh në pemë. Aktivitete të tilla janë thelbësore për formimin e inxhinierëve të ardhshëm pyjorë dhe për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e mbrojtjes së ekosistemeve natyrore. **Lexo më shumë...**



# Vizitorë ndërkombëtare në UBT



## Studentë nga Turqia ndjekin leksion mbi biosigurinë në UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës mirëpriti një grup prej 7 studentësh nga Turqia, të cilët morën pjesë në një leksion të posaçëm mbi biosigurinë në praktikat veterinarë, të zhvilluar nga Prof. Dr. Xhelil Koleci, pranë Fakultetit të Mjekësisë Veterinarë. [\*\*Lexo më shumë...\*\*](#)

Studentët ndanë përshtypjet e tyre nga qëndrimi disa-ditor në Shqipëri në Rektoratin e UBT duke vlerësuar mikpritjen, përvojën akademike dhe ambientin universitar, ndërsa u shprehën se po largohen me mbresat më të mira nga kjo eksperiencë. [\*\*Lexo më shumë...\*\*](#)



## Profesori nga Polonia ndan eksperiencën në UBT: Fokus tek inovacioni dhe e ardhmja e bujqësisë

Profesori Marek Gaworski, nga Universiteti i Shkencave të Jetës në Varshavë, Poloni, vizitoi Universitetin Bujqësor të Tiranës në kuadër të programit ndërkombëtar Erasmus+ Programme, duke sjellë një perspektivë bashkëkohore mbi zhvillimet në sektorin e bujqësisë.

Gjatë qëndrimit të tij në UBT, prof. Gaworski pati mundësinë të zhvillojë një leksion për studentët, ku ndau përvojën e tij në fushën e prodhimit të qumështit, një nga specializimet kryesore të tij. Ai theksoi rëndësinë e përfshirjes së teknologjisë në bujqësi, duke u ndalur veçanërisht tek sfidat dhe nevoja për modernizim të sektorit.



Ai vlerësoi kushtet që ofron UBT për studim dhe kërkim shkencor, duke përmendur infrastrukturën moderne dhe laboratorët e mirëpajisur si elementë kyç për zhvillimin akademik. [\*\*Shiko videon...\*\*](#)